



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Nr. 507 Prot.

Tiranë, më 23.01. 2011



MIRATOHET

MINISTRI

*Myqerem Tafaj*  
MYQEREM TAFAJ

**PROGRAMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E  
RREGULLUAR TË MËSUESIT**

**1. Hyrje**

**1.1 Programi i praktikës profesionale për profesionin e mësuesit**

Programi i praktikës profesionale është hartuar për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin profesional të praktikantëve, kandidatë për mësues të rinj. Ai synon të nxisë praktika efektive të mësimdhënies, të të nxënit dhe vlerësimit të nxënësve. Programi realizohet gjatë periudhës së një viti shkollor, në mënyrë që kandidatët për mësues të zhvillojnë aftësitë, shprehitë dhe njohuritë e duhura që u nevojiten për të pasur sukses në profesionin e tyre si mësues.

Për hartimin e programit, janë mbajtur parasysh këto dokumente themelore:

- Ligji Nr. 10 171, datë 22.10.2009, i ndryshuar

- Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 336, datë 14.07.2011 për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.
- Rregullorja “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.
- Shtojcat e Rregullores.

Të gjitha këto dokumente, së bashku me programin e praktikës profesionale, mund të gjenden dhe në faqen e internetit e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al) dhe Institutit të Zhvillimit të Arsimit [www.izha.edu.al](http://www.izha.edu.al)

Programi i praktikës profesionale është ndërtuar si një material burimor, i bazuar gjerësisht në Rregulloren e miratuar të kësaj praktike. Përdoruesit e tij: praktikantët, mentorët, drejtuesit e shkollave, Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore duhet t’i referohen Rregullores për shpjegime të mëtejshme të procesit, rolit dhe përgjegjësi, si edhe modelit të instrumenteve përkatës për procesin. Programi ofron gjithsesi një pamje të përgjithshme të procesit, rolit dhe përgjegjësi, me një fokus të veçantë në aspektin përmbajtësor të praktikës.

Programi është i organizuar në tre pjesë kryesore.

**Pjesa e parë** paraqet një hyrje dhe një pamje të përgjithshme të programit, qëllimit të tij dhe dokumenteve ku bazohet.

**Pjesa e dytë** është një përcaktim i detajuar i kompetencave që duhet të fitojë praktikanti në përfundim të praktikës profesionale.

**Pjesa e tretë** ofron një përmbledhje të procedurës së vlerësimit dhe monitorimit të praktikantit.

## 1.2 Qëllimi i programit

Programi i praktikës profesionale synon që të ofrojë për mësuesit e ardhshëm një sistem mbështetjeje që përfshin të nxënë të mjedisin e punës, duke punuar me një mentor të kualifikuar për të rritur efektivitetin e mësimit dhe rezultatet e të nxënë. Ai synon

të nxitë motivimin e mësuesve të ardhshëm për profesionin e edukatorit mësimdhënës, të nxitë bashkëpunimin e tyre me komunitetin e shkollës dhe të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale.

Programi i praktikës profesionale ka dy qëllime kryesore:

- Të ndihmojë praktikantët të realizojnë një përgatitje gjithëvjetrore dhe të ngrenë nivelin e zhvillimit të tyre profesional.
- Të ndihmojë drejtoritë e shkollave dhe mentorët të udhëheqin dhe të lehtësojnë procesin e zhvillimit profesional të praktikantëve përgjatë praktikës së tyre profesionale.

### **1.3 Elementet kryesore të programit të praktikës profesionale**

Mësuesit e rinj kanë nevojë për një program praktike profesionale që ofron mbështetje në tri dimensione: në atë personal, social dhe profesional. Programi i paraqitur merr parasysh të tre këto dimensione, të cilët janë përshkruar sipas dokumenteve europiane për hartimin e programeve të praktikave profesionale për mësuesit fillestarë.

#### **Dimensioni personal**

Mbështetja personale ndihmon mësuesin e ri të zhvillojë identitetin e tij si mësues. Në muajt dhe vitet e para të profesionit atij i duhet të kapërcejë sfida profesionale dhe personale të ndryshme. Ky dimension përfshin zhvillimin dhe përpunimin e normave personale për marrëdhëniet me nxënësit dhe kolegët, përpunimin e këndvështrimeve për të nxënit, mësimdhënien dhe rolin e tij në këto procese, si dhe zhvillimin e një qëndrimi të nxënit afatgjatë etj. Në këtë dimension, emocionet dhe perceptimet e vetëfikasitetit dhe vetëvlerësimit të mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm.

Për të krijuar këtë mbështetje, është e rëndësishme të përmbushen disa elemente, si: mbështetja nga mentori dhe kolegët, mjedisi i sigurt i punës dhe ngarkesa e reduktuar e punës.

### **Dimensioni social**

Programi i praktikës ndihmon mësuesin e ri për t'u ndjerë pjesë organike e shkollës dhe komunitetit profesional, për të kuptuar dhe pranuar cilësitë, normat, mënyrat dhe strukturën organizative brenda shkollës. Bashkëpunimi me të tjerët nxit shkëmbimin e ideve. Një faktor i rëndësishëm në mbështetjen sociale është kultura e shkollës. Mësuesit fillestarë ndihen më të pranuar brenda një ekipi që është i hapur ndaj ideve të reja. Mbështetja sociale mundëson krijimin dhe mbështetjen e një mjedisi të nxëni bashkëpunues brenda shkollës dhe aktorëve të arsimit. Elemente të mbështetjes sociale mund të jenë mbështetja nga mentori dhe bashkëpunimi i ngushtë me mësues të tjerë.

### **Dimensioni profesional**

Praktika profesionale synon të zhvillojë shprehitë efektive të mësimdhënies në klasë dhe të thellojë njohuritë e lëndës, pedagogjisë dhe didaktikës. Me mbështetjen profesionale sigurohet një fillim i mbarë në procesin e të nxënit afatgjatë. Elemente të kësaj mbështetjeje janë kontributet nga ekspertët e universiteteve apo institucioneve të trajnimit të mësuesve në formën e kurseve dhe shkëmbimit të njohurive praktike midis mësuesve fillestarë dhe atyre me përvojë në shkolla të ndryshme.

**Tabela 1.** Llojet e mbështetjes për mësuesit fillestarë

	<b>Personal</b>	<b>Social</b>	<b>Profesional</b>
<b>Synimet e programit</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Të zhvillojë identitetin si mësues.</li><li>- Të përforcojë kompetencat kyçe të mësimdhënësit.</li><li>- Të rrisë vetëbesimin.</li><li>- Të reduktojë stresin.</li><li>- Të motivojë dhe të shmangë tërheqjen e mësuesve të rinj nga detyra.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Të rrisë shoqërimin në shkollë dhe profesion.</li><li>- Të nxisë bashkëpunimin mes kolegëve.</li><li>- Të nxisë krijimin e një mjedisi të nxëni bashkëpunues.</li><li>- Të nxisë përfshirjen e komunitetit të shkollës.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Të zhvillojë më tej kompetencat e mësuesve.</li><li>- Të lidhë edukimin fillestar të mësuesit me zhvillimin e vazhdueshëm profesional.</li><li>- Të rrisë profesionalizmin e mësuesve fillestarë.</li></ul>

<b>Kërkesat kyçe</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjedis i sigurt, jo paragjykues.</li> <li>- Ngarkesë pune e reduktuar.</li> <li>- Mësimdhënie në ekip dhe bashkëpunim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Puna në bashkëpunim</li> <li>- Bashkëpunimi në mësimdhënie.</li> <li>- Punë grupi.</li> <li>- Grupe projektsh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkëmbime eksperiencash mes mësuesve me përvojë dhe mësuesve të rinj.</li> <li>- Kualifikime të vazhdueshme.</li> <li>- Këshillime</li> </ul>
<b>Sistemet e duhura të mbështetjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mentorët</li> <li>- Kolegët</li> <li>- Vetëvlerësim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mentorët</li> <li>- Kolegët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mentorët</li> <li>- Kolegët</li> <li>- Ekspertët</li> <li>- Vetëvlerësim</li> </ul>
© Komisioni European, 2010			

## 2. Kompetencat

Kompetencat përfshijnë aftësi, dije dhe qëndrime që kërkohen të arrihen nga mësuesit e rinj në përfundim të praktikës së tyre profesionale. Këto kompetenca janë përcaktuar në Shtojcën 3 të Rregullores, ku praktikanti duhet:

- të njohë dokumentacionin zyrtar dhe ta plotësojë atë në përputhje me rregullat zyrtare;
- të jetë i përgatitur nga ana shkencore;
- të zhvillojë mësimdhënie sipas praktikave të suksesshme bashkëkohore;
- të formojë te nxënësit aftësi ndërkurrikulare;
- të përkujdeset për suksesin e çdo nxënësi;
- të vlerësojë sistematikisht nxënësit me larmi mënyrash vlerësimi;
- të respektojë normat e etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor;
- të jetë aktiv në bashkëpunimin me kolegët

Çdo kompetencë i përket një fushe të caktuar dhe është e zërthyer në disa objektiva.

Fusha	Kompetenca	Objektivat
<b>Legjislacioni arsimor dhe dokumentacioni i mësuesit</b>	<b>Njeh dokumentacionin zyrtar dhe e plotëson në përputhje me rregullat zyrtare</b>	Praktikanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njohë ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të institucionit arsimor parauniversitar;</li> <li>- të zbatojë udhëzimin e MASH-it për vitin shkollor kur praktikanti bën praktikën;</li> <li>- të njohë dhe të marrë pjesë në organizimin dhe funksionimin e strukturave organizative të shkollës;</li> <li>- të zbatojë udhëzimet për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>- të zbatojë udhëzimet për zbatimin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar;</li> <li>- të zbatojë në praktikën e përditshme kërkesat që burojnë nga ky dokumentacion;</li> <li>- të demonstrojë zbatimin konkret të udhëzimeve të MASH-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie - mësimnxënies;</li> <li>- të zbatojë udhëzimet për personelin e shkollës;</li> <li>- të respektojë të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>- të respektojë detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>- të zotërojë kriteret dhe parimet e plotësimit të dokumentacionit shkollor, si regjistri, dëftesa, amza etj.;</li> <li>- të zotërojë dhe zbatojë rregullat dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit shkollor, nisur</li> </ul>

		nga vendimet dhe urdhëresat e MASH-it.
<b>Dokumentacioni kurrikular për profilin përkatës dhe përmbajtja shkencore e lëndës/lëndëve</b>	<b>Është i përgatitur nga ana shkencore</b>	<p>Praktikanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë strukturën e programeve të lëndës që jep mësim (formatin dhe rubrikat e tij, parimet dhe kriteret, linjat dhe nënlinjat) për të gjitha klasat, brenda ciklit;</li> <li>- të zotërojë njohuritë lëndore me saktësi shkencore;</li> <li>- të planifikojë orët mësimore dhe veprimtaritë e mësimdhënies, duke u mbështetur në programin mësimor dhe standardet e të nxënit të lëndës dhe fushës;</li> <li>- të planifikojë objektivat e arritjes sipas njohurive, aftësive, qëndrimeve e vlerave dhe sipas niveleve;</li> <li>- të planifikojë burime të shumëllojshme të të nxënit, duke bashkëpunuar me kolegët, prindërit e komunitetin;</li> <li>- të zgjedhë dhe përdorë tekstin mësimor në përputhje me objektivat e programit;</li> <li>- të përditësojë informacionin e tekstit, duke përdorur burime të ndryshme informacioni.</li> </ul>
<b>Praktikat bashkëkohore të suksesshme të mësimdhënies e nxënies dhe të vlerësimit të nxënësve</b>	<b>Zhvillon mësimdhënie sipas praktikave të suksesshme bashkëkohore</b>	<p>Praktikanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përshkruajë metodologjitë, strategjitë dhe teknikat bazë të mësimdhënies së lëndës;</li> <li>- të përcaktojë lidhjen ndërmjet objektivave dhe metodologjive, strategjive dhe teknikave bazë të mësimdhënies së lëndës;</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përzgjedhë metodologji, strategji dhe teknika të organizimit të mësimit të bazuar në objektivat e orës së mësimit;</li> <li>- të demonstrojë praktikisht përdorimin e metodologjive, strategjive dhe teknikave bazë të mësimdhënies së lëndës në një orë mësimi;</li> <li>- të evidentojë dhe përdorë mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të përzgjedhura për një orë mësimi;</li> <li>- të dallojë tri nivele të arritjeve të nxënësve në një listë objektivash;</li> <li>- të hartojë objektiva specifike të arritjeve të nxënësve në tri nivele, nisur nga objektivat e programit;</li> <li>- të ndërtojë pyetje ose veprimtari mësimore që mundësojnë vlerësimin e nxënësve në tri nivele;</li> <li>- të përshkruajë forma dhe teknika të ndryshme të vlerësimit të tyre;</li> <li>- të demonstrojë përdorimin e formave dhe teknikave të ndryshme të vlerësimit të nxënësve;</li> <li>- të zbatojë parimet e hartimit të një testi;</li> <li>- të hartojë teste për matjen dhe diagnostikimin në vazhdimësi të arritjeve të nxënësve.</li> </ul>
	<b>Vlerëson sistematikisht nxënësit me një larmi mënyrash vlerësimi</b>	
<b>Përdorimi i TIK-ut, Gjuhës shqipe,</b>	<b>Synon të formojë te nxënësit aftësi ndërkurrikulare</b>	<p>Praktikanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë dhe zbatojë me efikasitet njohuritë</li> </ul>



<p><b>Matematikës, Gjuhës së huaj pavarësisht profilit përkatës si kompetenca kroskurrikulare</b></p>		<p>bazë të lexim - shkrimit digjital;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të hartojë projekte kurrikulare, ku të jetë i përfshirë TIK-u;</li> <li>- të njohë dhe të vërë në praktikë programet kryesore kompjuterike (Word, PowerPoint, Internet etj.);</li> <li>- të hartojë mjete didaktike për një mësimdhënie interaktive;</li> <li>- të njohë standardin e gjuhës shqipe dhe të zbatojë normat e tij në veprimtaritë institucionale;</li> <li>- të njohë strukturën, llojet dhe parimet e përgjithshme të shkrimit të një eseje; të hartojë ese të llojeve të ndryshme.</li> </ul>
<p><b>Zhvillimi moshor dhe marrëdhëniet me fëmijët dhe të rinjtë</b></p>	<p><b>Përkujdeset për suksesin e çdo nxënësi</b></p>	<p>Praktikanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përdorë njohuritë mbi zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve në arsimin parauniversitar në veprimtaritë e mësimdhënies;</li> <li>- të përgjigjet në mënyrën e duhur ndaj nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara ose vështirësi në të nxënë;</li> <li>- të përshtatë mësimdhënien në forma të ndryshme në përputhje dhe në dobi të stilit individual të të nxënësve tek nxënësit;</li> <li>- të zhvillojë dhe mbështesë marrëdhënie të hapura me fëmijët, të bazuara mbi respektin dhe besimin e ndërsjellë;</li> <li>- të motivojë nxënësin për të përmirësuar të nxënësit e tij.</li> </ul>

<b>Komunikimi dhe bashkëpunimi në grup</b>	<b>Respekton normat e etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor</b>	Praktikanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të demonstrojë një qëndrim pozitiv dhe profesional gjatë komunikimit me prindërit, nxënësit dhe kolegët;</li> <li>- të komunikojë tek nxënësit pritshmëri të qarta, të arritshme dhe motivuese;</li> </ul>
	<b>Është aktiv dhe produktiv në bashkëpunimin me kolegët</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të zbatojë rregullat e të punuarit në grup dhe në ekip;</li> <li>- të përdorë mënyra të larmishme për të shkëmbyer informacionin me kolegët;</li> <li>- të mbështesë veprimtari dhe programe, të cilat inkurajojnë prindërit të marrin pjesë aktivisht në veprimtaritë e organizuara në shkollë.</li> </ul>

### 3. Vlerësimi

#### 3.1 Portofoli i praktikantit

Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, praktikanti duhet të plotësojë portofolin e tij me përvojat më të mira të fituara. Portofoli përmban: planin lëndor vjetor, objektiva të arritjeve të nxënësve për një kapitull, plane ditore të orëve mësimore, teste të orëve mësimore dhe të kapitujve, projekte kurrikulare të zhvilluara me nxënësit, shembuj të përdorimit nga praktikanti të burimeve të mësimdhënies (përveç tekstit të nxënësit), shembuj të metodave që ka përdorur praktikanti për të formuar te nxënësit aftësitë e komunikimit me gojë dhe me shkrim, të menduarit kritik, të menduarit krijues, të punuarit në grup, të menaxhimit nga nxënësit të informacionit mësimor nga burime të ndryshme, të përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie, të përdorimit të Matematikës e Gjuhës shqipe në mësimdhënie, të punës me nxënësit me vështirësi në të nxënë, si edhe të punës me nxënësit me prirje të veçanta. Portofoli duhet të përmbajë gjithashtu “Raportin

e praktikantit” me reflektime mbi përvojat e tij gjatë praktikës profesionale, me sukseset më të spikatura dhe vështirësitë kryesore.

### **3.2 Vlerësimi i praktikantit**

Ky program i mundëson praktikantit që të vetëvlerësohet duke u ballafaquar me treguesit dhe pritshmëritë e praktikës profesionale. Programi është i vlefshëm gjithashtu për mentorin dhe drejtuesin e institucionit arsimor, të cilët do të vlerësojnë praktikantin kundrejt arritjes së treguesve të çdo kompetence sipas shtojcave të Rregullores.

### **3.3 Literatura**

Praktikanti do të mbështetet dhe do të përdorë burime të literaturës bashkëkohore për të plotësuar dhe përforcuar njohuritë dhe aftësitë e tij. Ai mund të këshillohet me mentorin, stafin e shkollës, institucionet e arsimit, si dhe me agjenci trajnuese të akredituara për sigurimin dhe shfrytëzimin e burimeve të saj.

Është e rëndësishme që gjatë periudhës së praktikës, praktikanti të konsultojë dhe shfrytëzojë materiale të botuara që i përgjigjen kompetencave të sipërpërmendura siç mund të jenë:

- Dokumente zyrtare të MASH-it në lidhje me legjislacionin dhe dokumentacionin shkollor;
- Dokumentacion kurrikular që lidhet me lëndën që zhvillon;
- Botime në fushën e mësimdhënies dhe të nxënësve;
- Botime në fushën e vlerësimit të arritjeve të nxënësve;
- Botime në fushën e psikologjisë së zhvillimit dhe edukimit;
- Botime që trajtojnë aspekte të komunikimit në shkollë;
- Botime në lidhje me zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare.
- Materiale evropiane dhe botërore që lidhen me këto kompetencave